



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2015-12

U

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 15 shtator 2014.

II. FAKTET

2. Me 7 shkurt 2012, ankuesi ka parashtruar në Zyrën e Kryeprokurorit të EULEX-it një dokument të emëruar “akuzë penale” ndaj kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Ai ka pohuar se në datat e mëparshme ai kishte parashtruar ankesa ndaj institucioneve të ndryshme në Kosovë në Gjykatën Kushtetuese dhe se rreth tyre nuk kishte marrë përgjigje të duhura.
3. Me 24 shkurt 2012, ankuesi ka marrë një letër nga kryeprokurori i EULEX-it nr. 37/2012, të datës 23 shkurt 2012, si përgjigje se në bazë të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 2008/L-53), ankesa e tij (akuza penale) ndaj kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nuk kishte hyrë në kompetencat e prokurorëve të EULEX-it. Ankuesi ishte këshilluar që duhej të kontaktonte me një avokat të kualifikuar ose t'i referohej Komisionit për ndihmë juridike në Pejë.
4. Më vonë në shkurt 2012, ankuesi ka paraqitur padi penale private ndaj kryetarit të Gjykatës Kushtetuese në Gjykatën Komunale të Prishtinës.
5. Me 2 prill 2013, ankuesi ka marrë një vendim, nr. 803/11 të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të datës 27 mars 2013, ku është refuzuar padia e tij penale me arsyetimin se në bazë të Kodit Penal që kishte hyrë në fuqi me 1 janar 2013, prokurori kishte të drejtë ekskluzive të parashtrij padi penale.
6. Në prill 2013, ankuesi ka parashtruar një ankesë ndaj vendimit të lartpërmendur.
7. Me 2 korrik 2013, ankuesi ka marrë një vendim, nr. PA1.407/2013 të Gjykatës së Apelit, të datës 15 maj 2013, ku ishte hedhur poshtë ankesa e tij.
8. Pas disa parashtrimeve të tjera në Zyrën e Prokurorit të Shtetit dhe Gjykatën e Apelit, me 14 qershor 2014, ankuesi ka parashtruar ankesë në EULEX në mënyrë që të ndërmer masa ligjore ndaj kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Ai thotë se nuk ka marrë ndonjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.
9. Me 4 shtator 2014, ai ka kërkuar nga EULEX-i që të shqyrtoj ankesën e tij dhe ka theksuar se prapë nuk ka pranuar ndonjë përgjigje.

III. ANKESAT

10. Ankuesi është duke kërkuar nga Paneli të konstatoj se prokurori i Shtetit, Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Gjykata e Apelit kanë shkelur ligjin. Ai më tej kërkon nga Paneli që ta kthej lëndën në Gjykatën e Apelit për rigjykim dhe të udhëzojë Gjykatën e Apelit lidhur me rezultatin e

vendimit. Ankuesi nuk i referohet ndonjë shkeljeje të kryer as nga kryeprokurori i EULEX-it e as nga ndonjë prokuror tjetër i EULEX-it.

11. Edhe pse parashtruesi i ankesës nuk i është referuar ndonjë të drejte të veçantë të të drejtave të njeriut apo ndonjë dispozite të të drejtave të njeriut, është e qartë nga përmbajtja e ankesës se pretendimet e tij kanë të bëjnë me shkeljen e pretenduar të nenit 6 (1) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtat e Njeriut dhe Lirive themelore ("Konventa").

IV. LIGJI

12. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
14. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv dhe kjo dispozitë përcakton që Paneli nuk është kompetent të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës.
15. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me procedurat që gjendet në prokurorinë e Shtetit, Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit të Kosovës. Ankuesi gjithashtu përmend kryeprokurorin e EULEX-it dhe ankesën e tij në EULEX, por ai nuk bën asnjë kërkesë apo pretendim në lidhje me ndonjë shkelje lidhur me to.
16. Nga kjo del se kjo ankesë bie jashtë mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe, rrjedhimisht, jashtë kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it (shih *Dekart Shkololli kundër EULEX-it*, 2015-3, 29 shkurt 2016, par. 10, *Qerim Begolli kundër EULEX-it*, 2014-27, 2 shkurt 2015, para. 12, *Mensur Fezaj kundër EULEX-it*, nr. 2014-20 26 gusht 2014, par. 9-10).
17. Paneli konstaton që edhe nëse supozohet se një gjyqtar i EULEX-it që ishte anëtar i Panelit ka nxjerrë vendimin e kundërshtuar, Paneli ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se në bazë të rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it Kosovë,

Paneli nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë në gjykatat e Kosovës. Paneli nuk ka juridiksion as mbi aspektet administrative e as mbi aspektet gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të gjykatës nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih *ndër të tjera, Fahri Rexhepi kundër EULEX-it*, nr. 2014-19, 10 nëntor 2014 par. 12; *Gani Zeka kundër EULEX-it*, 2013-15, 4 shkurt 2014 par. 13).

18. Nga kjo del se ankesa nuk hyn në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe

SHBALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese